



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

Komuna e Kamenicës
Opstina Kamenica
Kamenica Municipality



KOMUNA E KAMENICËS

DREJTORI E ARSIMIT

PLANI STRATEGJIK PËR MËSIM TËRËDITOR NË SHFMU NË KOMUNËN E KAMENICËS

**KORRIK 2025
KAMENICË**

PËRMBAJTJA

Lista e figurave	3
Lista e tabelave	4
Grupi punues.....	5
Vendimi i Kryetarit z. Kadri Rahimaj.....	6
Deklaratë në lidhje me Planin Strategjik për Mësimin Tërëditor	8
Qëllimi	9
1. Hyrja	10
2. Metodologjia	11
3. Misioni	12
4. Vizioni	13
5. FUSHAT MBI ORGANIZIMIN INSTITUCIONAL	14
Fusha 1: Planifikimi dhe organizimi institucional	14
Fusha 2: Mësimi dhe mbështetja akademike	16
Fusha 3: Edukimi emocional dhe social	18
Fusha 4: Aktivitetet fizike dhe rekreative	21
Fusha 5: Krijimtaria dhe arti	22
Fusha 6: Kujdesi dhe mirëqenia.....	23
6. PËRFSHIRJA E PRINDËRVE DHE KOMUNITETIT	26
7. SWOT analiza.....	27
8. ANALIZA E GJENDJES NË SHKOLLA.....	28
9. Krahasimi në mes të institucioneve private dhe publike të ofrimit të mësimit tërëditor në shkolla	34
10. INFRASTRUKTURA, ORGANIZIMI DHE PASQYRA E FONDIT TË ORËVE MËSIMORE 2025/26 38	
12. VLERËSIMI DHE MONITORIMI.....	51
13. REKOMANDIMET	53
14. PLANI I VEPRIMIT	55

Lista e figurave

Figura 1. Orari i zilës që vlen për v.sh. 2025/26.....	38
Figura 2. Modeli se di do të mund të duket orari mësimor	39
Figura 3. Pasqyra e lëndët kurrikulare – ShFMU “Metush Krasniqi”	40
Figura 4. Pasqyra e lëndët jashtë kurrikulare – ShFMU “Metush Krasniqi”	41
Figura 5. Ndarja e lëndëve në nivelin 0 – 5 - ShFMU “Metush Krasniqi”	41
Figura 6. Ndarja e lëndëve në nivelin 0 – 5 - ShFMU “Metush Krasniqi”	42
Figura 7. Fondi i orëve në total për v.sh. 2025/25 - ShFMU “Metush Krasniqi”	42
Figura 8. Pasqyra e lëndët kurrikulare – ShFMU “Abdullah Krashnica”	43
Figura 9. Pasqyra e lëndët jashtë kurrikulare – ShFMU “Abdullah Krashnica”	44
Figura 10. Ndarja e lëndëve në nivelin 0 – 5 - ShFMU “Abdullah Krashnica”	45
Figura 11. Ndarja e lëndëve në nivelin 0 – 5 - ShFMU “Abdullah Krashnica”	45
Figura 12. Fondi i orëve në total për v.sh. 2025/25 - ShFMU “Abdullah Krashnica”	46
Figura 13. Pasqyra e lëndët kurrikulare – ShFMU “Skenderbeu”	46
Figura 14. Pasqyra e lëndët jashtë kurrikulare – ShFMU “Abdullah Krashnica”	47
Figura 15. Ndarja e lëndëve në nivelin 0 – 5 - ShFMU “Skenderbeu”	48
Figura 16. Ndarja e lëndëve në nivelin 0 – 5 - ShFMU “Skenderbeu”	48
Figura 17. Fondi i orëve në total për v.sh. 2025/25 - ShFMU “Abdullah Krashnica”	48

Lista e tabelave

Tabela 1. Përshkrimi për tabelar i fushës: planifikimi dhe organizimi institucional	16
Tabela 2. SWOT analiza	27
Tabela 3. Stafi dhe burimet njerëzore	28
Tabela 4. Vlerësimet e përgjithshme.....	29
Tabela 5. Stafi dhe burimet njerëzore	30
Tabela 6. Vlerësimet e përgjithshme.....	30
Tabela 7. Stafi dhe burimet njerëzore	32
Tabela 8. Vlerësimet e përgjithshme.....	32
Tabela 9. Krahësimi i strukturës së orarit mësimor	34
Tabela 10. Mësimdhënie dhe stafi	35
Tabela 11. Përfshirja e prindërve	36
Tabela 12. Qëllimi edukativ dhe vlerat	36
Tabela 13. Resurset dhe infrastruktura.....	37
Tabela 14. Kostoja dhe qasja	37

Grupi punues

Nr	Emri dhe mbiemri	Institucioni	Pozita
1	Kadri Rahimaj	Kryetar i Komunës	
2	Afrim Dërvishi	Drejtore e Arsimit	Kryesues
3	Selami Klaiqi	Drejtore Gjinnazi “Ismail Qemali”	Koordinator
4	Visar Dërmaku	Drejtoria e arsimit	Anëtar
5	Ramadan Guda	Drejtoria e arsimit	Anëtar
6	Merita Keqmezi	Drejtore ShFMU “Abdullah Krashnica”	Anëtare
7	Belgizare Kryeziu	Drejtore ShFMU “Metush Krasniqi”	Anëtare
8	Besim Kryeziu	Mësimdhënëse ShFMU “Metush Krasniqi”	Anëtar
9	Xhevrije Sabedinaj	Psikologe Gjinnazi “Ismail Qemali”	Anëtare
10	Sabit Zylfijaj	Mësimdhënëse Gjinnazi “Ismail Qemali”	Anëtar
11	Agon Mahmuti	u.d. drejtore IAAP “Andre Durrsaku”	Anëtar
12	Hanife Ferizaj	Pedagoge ShFMU “Skenderbeu”	Anëtare
13	Arsim Guda	Drejtore ShFMU “Skenderbeu”	Anëtar
14	Avni Maliqi	Mësimdhënëse ShFMU “Abdullah Krashnica”	Anëtar
15	Hazbije Haxhiu	Mësimdhënëse ShFMU “Rexhep Mala”	Anëtare
16	Afërdita Kallaba	Mësimdhënëse ShFMU “Metush Krasniqi”	Anëtare
17	Adem Hashani	Mësimdhënëse ShFMU “17 shkurti”	Anëtar
18	Bejaze Morina	Drejtoria e arsimit	Anëtare
19	Flori Hoda	Mësimdhënëse ShFMU “Fan Noli”	Anëtare

Vendimi i Kryetarit z. Kadri Rahimaj



Zyra e Kryetarit

Sh.02.Nr.131, datë: 01.04.2025

Duke u bazuar në nenin 13 dhe 58, të Ligjit Nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale, publikuar në "Gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës, Nr-28/2008", në mbështetje të nenit 44, lidhur me nenin 49, të Ligjit Nr. 05/L-031, për Procedurën e Përgjithshme Administrative, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-20/2016", Dispozitave të Ligjit Nr. 03/L-068 për Arsimin në Komunitet të Republikës së Kosovës, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 04/L-115, si dhe Ligjin Nr. 04/L-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, dhe aktet tjera nënligjore, neni 70 paragrafi 70.1 të Statutit Sh.01.Nr.20203 të datës 21.06.2023 të Komunës së Kamenicës, Kryetari i Komunës nxjerr këtë:

VENDIM

1. Me këtë vendim themelohet Grupi Punues për Hartimin e Planit për Qëndrimin Gjithëditor në shkollat të Komunës së Kamenicës, Përbërja e grupit punues do të jetë si në vijim:

- 1.1. Afrim Dërvishi (Drejtorja Komunale e Arsimit), Kryesues;
- 1.2. Selami Klaiqi (Drejtor Gjinnazi "Ismail Qemali"), Koordinator;
- 1.3. Visar Dërmaku (Drejtorja Komunale e Arsimit), anëtar;
- 1.4. Ramadan Guda (Drejtorja Komunale e Arsimit), anëtar;
- 1.5. Merita Keqmezi (Drejtorja Shkollat Fillore "Abdullah Krashnica", Koretin), anëtare;
- 1.6. Belgizare Kryeziu (Drejtorja Shkollat Fillore "Metush Krasniqi", Rogaçicë), anëtare;
- 1.7. Besim Kryeziu (Mësimdhënësi Shkollat Fillore "Metush Krasniqi", Rogaçicë), anëtar;
- 1.8. Xhevrije Sabedinaj (Psikologja Gjinnazi "Ismail Qemali", Kamenicë), anëtare;
- 1.9. Sabit Zylfijaj (Mësimdhënësi Gjinnazi "Ismail Qemali", Kamenicë), anëtar;
- 1.10. Agon Mahmuti (Mësimdhënësi IAAP "Andrea Durrsaku", Kamenicë), anëtar;
- 1.11. Hanife Ferizaj (Pedagogja Shkollat Fillore "Skenderbeu", Hogosht), anëtare;
- 1.12. Arsim Guda (Drejtor Shkollat Fillore "Skenderbeu", Hogosht), anëtar;
- 1.13. Avni Maliqi (Mësimdhënësi Shkollat Fillore "Abdullah Krashnica", Koretin), anëtar;
- 1.14. Hazbije Haxhiu (Mësimdhënësi Shkollat Fillore "Rexhep Mala", Topanice), anëtare;
- 1.15. Aferdita Kallaba (Mësimdhënësi Shkollat Fillore "Metush Krasniqi", Rogaçicë), anëtare;
- 1.16. Adem Hashani (Mësimdhënësi Shkollat Fillore "17 Shkurti", Muçivërcë), anëtar;
- 1.17. Bejaze Morina (Drejtorja Komunale e Arsimit), anëtare; dhe
- 1.18. Florije Hoda (Mësimdhënësi Shkollat Fillore "Fan S. Noli", Kamenicë), anëtare.

2. Detyrat e grupit punues:

- 2.1. Hartimi i planit të detajuar profesional për qëndrimin gjithëditor në shkolla.
 - 2.2. Përgatitja e planit financiar për zbatimin e programit.
 - 2.3. Përzgjedhja e shkollave pilot.
 - 2.4. Krijimi i mekanizmave të bashkëpunimit me institucionet arsimore dhe organizatat relevante.
 - 2.5. Dorëzimi i planit final pranë Kryetarit të Komunës.
3. Drejtoria Komunale e Arsimit (DKA) merr përsipër mbulimin e shpenzimeve që rrjedhin nga puna dhe organizimet e grupit punues.
 4. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Drejtoria Komunale e Arsimit, ndërsa mbikëqyrjen për zbatimin e tij e bën Kryetari i Komunës.
 5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

T'i dorëzohet: Zyrës së Kryetarit, Zyrës së Informimit, Drejtorisë Komunale të Arsimit, Anëtarëve të Grupit Punues dhe arkivit.


Kryetari i Komunës

Kadri Rahimaj

Deklaratë në lidhje me Planin Strategjik për Mësimin Tërëditor



Të nderuar anëtarë të kolektivit arsimor të Kamenicës,

Të nderuar prindër,

Të dashur nxënës,

Kam kënaqësinë dhe përgjegjësinë e veçantë që, në emër të Komunës së Kamenicës, të paraqes këtë Plan Strategjik për Mësimin Tërëditor, i cili përbën një hap thelbësor drejt një shkolle më gjithëpërfshirëse, më të barabartë dhe më cilësore.

Ky është një nga dokumentet më strategjike dhe më të rëndësishme që është hartuar në dy dekadat e funksionimit të komunës sonë. Ky plan vjen si përgjigje ndaj nevojës për të ndërtuar një sistem arsimor që jo vetëm mëson, por edhe edukon, përkujdeset dhe zhvillon tërësisht fëmijën – intelektualisht, emocionalisht dhe shoqërisht.

Plani që kemi hartuar është rezultat i një pune të përbashkët e profesionale të mësimdhënësve, drejtorëve, ekspertëve arsimorë dhe partnerëve tanë. Mësimi tërëditor nuk është vetëm zgjatje e orarit, por një qasje e re arsimore, që e vendos fëmijën në qendër të çdo veprimi. Ky model na ndihmon të ngadalësojmë shpërnguljen, të rrisim cilësinë e të nxënësve dhe të mbrojmë mirëqenien e fëmijëve tanë, duke siguruar kushte të përafërta me ato të vendeve më të zhvilluara në Evropë dhe në botën e zhvilluar.

Si kryetar i Komunës, mbetem i përkushtuar të ofroj mbështetje të pakushtëzuar për zbatimin e këtij plani dhe garantoj se do të punojmë së bashku për ta bërë atë të realizueshëm në sistemin tonë arsimor, së bashku me të gjithë akterët e shoqërisë sonë.

Ftoj mësimdhënësit të udhëheqin me pasion, prindërit të përfshihen aktivisht dhe komunitetin të qëndrojnë pranë shkollës. Sepse pikërisht aty fillon cilësia e jetës sonë shoqërore dhe familjare.

Më lejoni t'ju them se suksesi i këtij plani nuk varet vetëm nga ajo që kemi shkruar, por nga mënyra se si do ta jetojmë dhe zbatojmë atë – me përkushtim, bashkëpunim dhe besim të ndërsjellë.

E ardhmja e fëmijëve tanë nuk ndërtohet nesër; ajo fillon sot – në klasë, në shkollë, në përkushtimin tonë ndaj dijes.

Arsimi nuk është vetëm një investim për zhvillim, por është vetë themeli i lirisë, i barazisë dhe i dinjitetit njerëzor.

Bashkë për Kamenicën që duam.

Sinqerisht,
Kadri Rahimaj

Kryetar i Komunës së Kamenicës

Qëllimi

Qëllimi i themelimit të grupit për hartimin e planit të detajuar profesional për mësimin tërëditor në shkollat fillore dhe të mesme të ulëta është krijimi i një strukture profesionale dhe pedagogjike, që siguron një organizim dhe program të përshtatshëm për fëmijët që qëndrojnë në shkollë për orar të zgjatur. Ky grup, ka si objektiv zhvillimin e një programi të integruar, i cili do të përfshij mësimin, aktivitetet jashtëkurrikulare, në funksion të zhvillimit të aftësive sociale, emocionale dhe fizike të fëmijëve.

Strategjia do të mundësojë një qasje të plotë për zhvillimin e nxënësve, duke iu ofruar mundësi për aktivitete edukative, kreative, dhe shoqërore, gjithashtu duke avancuar rezultatet lëndore dhe begatuar jetën shkollore gjatë gjithë ditës.

Prindërve do t'iu mundësohet që fëmijët të kenë një ambient komod, siguria do të jetë në nivelin më të lartë, zhvillimi shkathtësive tek nxënësit do të synohet të jetë i barasvlershëm me shtetet më të zhvilluara, duke synuar që ngritja e cilësisë të jetë prioritet.

Është shumë e nevojshme dhe e domosdoshme që të fillohet implementimi i mësimin tërëditor në shkollë, ngase kjo do të ndikonte direkt në uljen e nivelit të shpërnguljeve të familje të komunës sonë me qëllimin e vetëm për të siguruar një ambient dhe cilësi më të lartë gjatë shkollimit të fëmijëve të tyre.

Në vitin shkollor 2025/26 do të fillohet mësimi tërëditor në tri shkolla në Komunën e Kamenicës për të mundësuar vazhdimin e përfshirjes edhe të shkollave të tjera gjatë viteve në vijim.

1. Hyrja

Strategjia e mësimi tërëditor është mënyrë e planifikuar dhe e strukturuar që do të mundësojë që mësimdhënësit të menaxhojnë të gjithë procesin mësimor në baza ditore. Kjo Strategji do ndihmojë në përfshirjen aktive të nxënësve, në ndërtimin e njohurive të reja dhe përforsimin e mësimëve të mëparshme, nevojën e rritjes së kreativitetit dhe rekreacionit në shkollë përmes aktiviteteve që do të organizohen gjatë mësimi tërëditor, nxitjen e të menduarit kritik tek nxënësit dhe, inkurajimin në zgjidhjen e problemeve. Duke zbatuar strategji të ndryshme – si puna në grupe, pyetjet nxitëse, përdorimi i mjeteve vizuale apo lojërat edukative – mësimdhënësit mund të përshtatin mësimin sipas nevojave të nxënësve dhe, të krijojnë një mjedis të gjallë e motivues për të nxënë. Synimi është që të inkurajohen mësimdhënësit dhe nxënësit që të rritet niveli i përdorimit të teknologjisë në mësimdhënie dhe mësim-nxënie, përdorimi i platformave digjitale, platformave elektronike të të mësuarit deri tek vlerësimi i standardizuar.

Kjo strategji është bazuar në dokumentet zyrtare të Republikës së Kosovës, Planin e Veprimit të Drejtorisë Komunale të Arsimit, Strategjinë e Arsimit të Republikës së Kosovës 2022-2026, dhe është në linjë me dokumente ndërkombëtare që paraqesin bazë për ndërtimin e politikave arsimore në vend. Strategjia për mësim tërëditor, mbështetet në legjislacionin ekzistues dhe rekomandimet e raporteve hulumtuese për arsimin në Kosovë që janë realizuar në vitet e fundit.

Në programin e Qeverisë po ashtu edhe në synimet tona si Komunë që do të jemi në të njëjtën linjë, janë përcaktuar 5 fusha si orientime kryesore për intervenim dhe zhvillim në sektorin e arsimit:

- **Arsimi cilësor gjithëpërfshirës dhe i digjitalizuar;**
- **Harmonizimi i arsimit dhe aftësimi profesional me kërkesat e tregut të punës;**
- **Menaxhimi efektiv i sistemit të arsimit në të gjitha nivelet;**
- **Arsimi i lartë me cilësi dhe integritet, në harmoni me standardet ndërkombëtare;**
- **Përmirësimi i mjedisit për kërkime dhe inovacion.**

Kjo strategji do të mundësojë ngritjen e cilësisë së arsimit parauniversitar përmes konsolidimit të mekanizmave për sigurim të cilësisë, dhe ofrimit të mësimdhënies cilësore. Përdorimi i teknologjisë digjitale për përmirësimin e shërbimeve dhe të cilësisë në arsim, në përputhje me trendet e transformimit digjital, krijimin e hapësirave ku nxënësit do të mund të zhvillonin shkathtësitë e nevojshme.

2. Metodologjia

Hapi i parë drejt zhvillimit të Strategjisë për Mësim Tërëditor ishte nga Kryetari i Komunës z. Kadri Rahimaj, i cili ka krijuar grupin punues për hartimin e planit për qëndrimin gjithëditor/mësimin tërëditor.

Shkollat e para tek të cilat do të aplikohet mësimi tërëditor janë përcaktuar si: ShFMU “Metush Krasniqi” në Roganë, ShFMU “Abdullah Krashnica” në Koretin dhe ShFMU “Skenderbu” me paralelen e ndarë në Kopernicë. Grupi punues i përbërë nga drejtor shkollash, mësimdhënës të fushave të ndryshme, Psikolog dhe Pedagog, ka mbajtur takime të rregullta me pjesëmarrje fizike dhe takime virtuale me qëllim të hartimit të një strategjie, e cila do të merrte në konsideratë të gjitha kushtet, sfidat dhe përparësitë e shkollave përkatëse, që më 01 Shtator 2025 të bëhen të gjitha përgatitjet e duhura që në këto shkolla të filloj së aplikuari mësimi tërëditor.

Përveq takimeve, punës së vazhdueshme të anëtarëve të grupit punës, mbi bazën e planit të veprimit, janë vizituar disa shkolla private dhe publike, të cilat janë duke aplikuar mësimin tërëditor në Kosovë, disa nga këto shkolla janë: “Hello Academy of Education” në Gjiilan, “Don Bosko” Gjiilan, “Mehmet Akif” Prishtinë, ShF “Model” Prishtinë, shkolla nga të cilat janë evidentuar sfidat të cilat mund të kalojnë shkollat tona gjatë implementimit të mësimi tërëditor.

Grupi punues gjatë fazës përgatitore ka zhvilluar takime konsultative për përcaktimin e metodologjisë së punës dhe formatit të strategjisë, gjatë fazës së analizës së gjendjes dhe hartimit të strategjisë janë bërë analiza të politikave dhe legjislacionit në Republikën e Kosovës, si dhe të raporteve e studimeve përkatëse, që ofrojnë informacion për situatën në sektorin e arsimit duke përfshirë këtu edhe Strategjinë e Arsimit 2022 – 2026. Po ashtu, janë shfrytëzuar të dhëna statistikore nga burime kombëtare dhe ndërkombëtare, duke bërë krahasime me vendet e tjera.

Grupi punues analizën e planifikimit e kanë mbështetur në analizën e situatës, duke dhënë përgjigje në sfidat tashmë të identifikuara, mënyrën e tejkalimit të këtyre sfidave, evidentimin e rasteve sfiduese, gjenerimin e plotë të pasqyrës së lëndëve kurrikulare, jashtë kurrikulare, fondin e orëve në secilin nivel dhe rekomandimet që do duhej të përmbushen si nga DKA po ashtu edhe nga shkollat përkatëse.

3. Misioni

Komuna e Kamenicës do të ofrojë një arsim cilësor, gjithëpërfshirës dhe të barabartë për të gjithë nxënësit, duke nxitur zhvillimin e plotë intelektual, social dhe emocional të tyre. Synojmë të krijojmë një mjedis të sigurt dhe motivues mësimor, ku çdo nxënës ka mundësi të zhvillojë potencialin e vet, të përgatitet për jetën dhe të kontribuojë si qytetar aktiv në shoqëri.

Do të mbështetemi gjithnjë në parimet e bashkëpunimit, përfshirjes së prindërve dhe komunitetit, zhvillimit të vazhdueshëm profesional të mësimitdhënësve dhe përdorimit të teknologjive bashkëkohore. për të përmbushur standardet moderne arsimore, nxënësve do të ofrojmë mësimin tërë ditë dhe prindërve do të ju mundësojmë që fëmijët e tyre të fitojnë shkathtësi të barabarta me bashkëmoshatarët e tyre në shtet më të zhvilluara

4. Vizioni

Komuna e Kamenicës ka vizion t'i promovojë vlerat për një arsim cilësor dhe shkencë, si çelës për përmirësimin e cilësisë të jetës të të gjithë qytetarëve tanë. Të ndërtojmë një sistem arsimor bashkëkohor dhe gjithëpërfshirës, ku çdo nxënës i Komunës së Kamenicës të ketë mundësi të barabarta për arsimim cilësor, zhvillim personal duke synuar të krijojmë shkolla që frymëzojnë kreativitet, mendim kritik, zgjidhjen e problemeve duke u mbështetur në mësimdhënie kreative, bashkëkohore, teknologji moderne dhe bashkëpunim të ngushtë me komunitetin.

5. FUSHAT MBI ORGANIZIMIN INSTITUCIONAL

Fusha 1: Planifikimi dhe organizimi institucional

Planifikimi dhe organizimi institucional në kuadër të zbatimit të mësimit tërëditor përfshinë aspektet kyçe që lidhen me mënyrën se si shkolla strukturohet dhe funksionon për të mbështetur këtë model. Kjo fushë është themelore, sepse siguron funksionim efikas të institucioneve shkollore.

Komponentët kryesore që përfshihen në këtë fushë:

1. **Hartimi i një Plani Strategjik për mësimin tërëditor**
2. **Organizimi i orarit mësimor dhe aktiviteteve jashtëkurrikulare**
3. **Menaxhimi institucional**
4. **Funksionimi i ekipeve punuese dhe aktiveve profesionale**
5. **Planifikimi i burimeve njerëzore**
6. **Dokumentacioni institucional**
7. **Mbështetja nga niveli komunal dhe bashkëpunimi me partnerë**

1. Hartimi i një Plani Strategjik për mësimin tërëditor

Zbatimi i mësimit tërëditor kërkon një plan strategjik të strukturuar, i cili përfshinë:

- **Qëllimin kryesor**, që është ngritja e cilësisë së të nxënësve që përfshin zhvillimin kognitiv, emocional, fizik dhe social të nxënësve;
- **Objektivat afatshkurtra**, si përgatitja e infrastrukturës bazë ku përfshihen hapësirat shkollore, riorganizimi i klasave etj.
- **Objektivat afatgjata**, rritja e cilësisë mësimore dhe përmirësimi i klimës në shkollë;
- **Identifikimin e burimeve njerëzore**, materiale, infrastrukturore dhe financiare;
- **Afatet kohore dhe fazat e zbatimit**, të përshkruara në një plan të detajuar vjetor.

2. Organizimi i orarit mësimor

Riorganizimi i orarit ditor të shkollës përfshinë:

- **Hartimi i orarit mësimor** duke përfshirë mësimin bazik dhe aktivitetet jashtëkurrikulare;
- **Organizimin e ushqimit** në shkollë sipas standardeve higjienike;
- **Pushimet e planifikuara** për çlodhje, socializim dhe ushqim;
- **Aktivitetet jashtëkurrikulare** si ndihma në detyra të shtëpisë, leximi, sporti, arti, kreativiteti dhe zhvillimi emocional.

3. Menaxhimi institucional

Organizimi i brendshëm i shkollës për të zbatuar mësimin tërëditor përfshinë:

- Roli udhëheqës i **drejtorit të shkollës** dhe ndarja e përgjegjësi për mbikëqyrjen e zbatimit;
- **Caktimi i një koordinatori të mësimin tërëditor**, që ndjek procesin dhe vepron si urë lidhëse mes stafit, prindërve dhe DKA-së;
- Zhvillimi i një **plani të komunikimit të brendshëm**, për mbledhje të rregullta dhe raportim sistematik;
- **Mbështetje nga këshilli i shkollës** dhe strukturat vendimmarrëse të institucionit.

4. Funksionimi i ekipeve punuese dhe aktiveve profesionale

Mësimin tërëditor mbështetet nga:

- **Aktivet profesionale të mësimdhënësve**, të ndara sipas fushave (mësim bazik (kurrikular), sport, mirëqenie, krijimtari, rekreacion);
- **Takimet javore të koordinimit**, për të ndarë përvojat, evidentuar sfidat dhe propozuar përmirësime;
- **Mbështetje ndërdisiplinore** për të realizuar një qasje gjithëpërfshirëse ndaj zhvillimit të nxënësit.

5. Planifikimi i burimeve njerëzore

Për të zbatuar me sukses mësimin tërëditor, shkolla duhet të:

- **Identifikojë nevojën për staf shtesë**, përfshirë mësues mbështetës, personel për kujdes dhe mbështetje, psikolog, kordinator për aktivitete të lira;
- **Përshtatja e orarit e punës** të stafit mësimor dhe jo-mësimor sipas strukturës së re të ditës;
- **Organizimin e trajnimeve për stafin** mbi qasjet bashkëkohore pedagogjike, menaxhimin e kohës, motivimin e nxënësve dhe bashkëpunimin ndërmjet kolegëve.

6. Dokumentacioni institucional dhe politika shkollore

Shkolla duhet të zhvillojë:

- **Udhëzues të brendshëm**, që përshkruajnë rregullat e funksionimit të përditshëm në kushte të ditës së zgjatur;
- **Rregullore për sjelljen e nxënësve**, sigurinë, mbrojtjen në raste emergjente dhe përfshirjen e të gjithëve pa përjashtim;
- **Rregullore për stafin dhe prindërit**, rregulloret të kalojnë në KDSH dhe të njëjtat të jenë të zbatueshme
- **Sistem për grumbullimin e të dhënave** (raporte, pyetësorë, tabela monitorimi) që do të përdoren për të vlerësuar dhe përmirësuar procesin

7. Mbështetja nga niveli komunal dhe bashkëpunimi me partnerë

Për një zbatim të qëndrueshëm:

- **Drejtoria Komunale e Arsimit (DKA)** duhet të ofrojë udhëzime, mbështetje financiare dhe mbikëqyrje administrative;
- Duhet kërkuar **partneritet me OJQ, agjenci zhvillimore dhe projekte të jashtme**, që mund të ndihmojnë në trajnime apo furnizime materiale;
- **Përfshirja aktive e prindërve dhe komunitetit lokal**, përmes takimeve informuese, aktiviteteve të përbashkëta dhe ndërtimit të besimit reciprok.

Tabela 1. Përshkrimi për tabelar i fushës: planifikimi dhe organizimi institucional

Nr.	Komponenti	Aktiviteti Kryesor	Afati	Burimet
1	Plani Strategjik për mësimin tërëditor	Hartimi i planit strategjik me objektiva, faza zbatimi dhe buxhetim	Qershor – Shtator 2025	Drejtori, Koordinatori, DKA
2	Organizimi i orarit mësimor dhe aktiviteteve jashëkurrikulare	Hartimi i orarit mësimor duke përfshirë edhe aktivitetet jashtë mësimore	Shtator 2025	Stafi pedagogjik, koordinatori, ekspertë të orarit
3	Menaxhimi institucional	Ndarja e përgjegjësiave dhe raportimi	Shtator 2025	Drejtori, stafi pedagogjik, këshilli i shkollës
4	Ekipet punuese dhe grupet profesionale	Formimi i ekipeve profesionale dhe planifikimi i takimeve të rregullta	Tetor 2025 – vazhdimisht	Mësimdhënësit, drejtoria, koordinatori
5	Planifikimi i burimeve njerëzore	Analizë e nevojave për staf dhe planifikimi i trajnimeve	Korrik – Nëntor 2025	Drejtoria, DKA, trajnerë profesionalë, buxhet
6	Dokumentacioni dhe politika shkollore	Draftimi i rregulloreve të brendshme të shkollës	Shtator – Tetor 2025	Drejtoria, koordinatorët, stafi pedagogjik
7	Mbështetja nga komuna dhe partnerët	Takime me DKA, aplikime për mbështetje, ndërtimi i partneriteteve	Gjatë gjithë vitit shkollor	Komuna, OJQ, donatorë, prindër

Fusha 2: Mësimi dhe mbështetja akademike

Në një kohë kur sistemi arsimor përballlet me sfida të shumta nga mungesa e burimeve, vështirësitë e nxënësve në të nxënë, deri te diversiteti i nevojave të nxënësve, një qasje e mirë planifikuar e mësimi dhe mbështetjes akademike është kyçe. Mësimi dhe mbështetja akademike bazohet në pesë komponentë themelorë: **identifikimi i nevojave, grupe mësimore të përshtatura, materiale të specializuara, trajnime për mësimdhënësit, dhe bashkëpunim me akterët lokalë.**

Organizimi i mësimi plotësues është një komponent thelbësor i procesit edukativo-arsimor, sidomos për nxënësit që hasin vështirësi në të nxënë. Kjo qasje bazohet në identifikimin e nxënësve me vështirësi në mësim dhe sigurimin e orëve ndihmëse apo mësimi plotësues, posaçërisht në lëndët bërthamë si gjuhë amtare dhe matematikë.

Mësimi plotësues është i strukturuar në formë të orëve shtesë, ku mësimdhënësit punojnë me grupe të vogla nxënësish, duke u përqendruar në konceptet themelore dhe zbatimin praktik të tyre. Për shembull, në gjuhën amtare përdoren fletore pune dhe ushtrime shtesë për të forcuar shkrimin, leximin dhe drejtshkrimin, ndërsa në matematikë, ushtrimet vizuale, problemet nga jeta reale dhe lojërat logjike ndihmojnë në kuptimin më të lehtë të njësive mësimore.

Procesi i identifikimit të nxënësve që kanë nevojë për mësim plotësues dhe shtesë do të zhvillohet gjatë muajve shtator dhe tetor. Gjatë kësaj periudhe, mësimdhënësit do të vëzhgojnë ecurinë dhe performancën e nxënësve përmes detyrave të përditshme, testeve diagnostike dhe angazhimit në orë. Nxënësit që tregojnë më së shumti vështirësi do të ndahen në grupe të vogla, të cilat do të ndjekin programin e mësimi plotësues.

Orët plotësuese realizohen nga mësimdhënësit gjatë aktiviteteve në pjesën e dytë të orarit mësimor, duke shfrytëzuar këtë kohë për të punuar me këta nxënës.

Ndarja e nxënësve që kanë nevojë për mësim plotësues në grupe të vogla, brenda orarit mësimor, sjell rritje të rezultateve në matematikë dhe lexim.

Për të rritur motivimin dhe angazhimin e nxënësve, veçanërisht atyre me vështirësi, mësimi plotësues shoqërohet me aktivitete atraktive si lojëra edukative, punë me materiale manipuluese dhe ushtrime në grup.

Në gjuhën amtare, kjo mundësohet nëpërmes leximit të tregimeve interesante, përgatitjes së fjalëve të reja, diskutimeve mbi tekstet e lexuara dhe diktimeve kreative. Leximi i drejtuar është një komponent i rëndësishëm i programit mbështetës në gjuhën amtare. Ky zhvillohet çdo javë dhe përfshin: leximin në grup të teksteve të përzgjedhura, diskutime mbi përmbajtjen, analizimin e mesazheve dhe karaktereve, si dhe ushtrime të drejtshkrimit dhe diktimit. Në këtë mënyrë,

forcohen shprehitë gjuhësore dhe analitike të nxënësve.

Klubet e shkencës janë forma alternative të mësimit shtesë për nxënësit që kanë potencial të madh dhe që dëshirojnë të avancojnë në fusha specifike si matematika, shkencat natyrore dhe teknologjia. Këto klube krijojnë mjedise që stimulojnë mendimin kritik, bashkëpunimin dhe kreativitetin.

Për një zbatim të suksesshëm të programeve mbështetëse, është e nevojshme një mbështetje e vazhdueshme nga Drejtoria Komunale e Arsimit (DKA). DKA duhet të ndihmojë në sigurimin e burimeve shtesë, trajnimeve për mësimdhënësit, si dhe në bashkëpunim me organizata joqeveritare që kanë përvojë në fushat edukative dhe sociale. Këto organizata mund të ofrojnë mentorim, mbështetje materiale dhe aktivitete jashtë mësimore që ndikojnë pozitivisht në zhvillimin e gjithanshëm të nxënësve.

Mësimi dhe mbështetja akademike për nxënësit me vështirësi nuk është vetëm përgjegjësi e mësimdhënësve, por një proces bashkëpunues që përfshin prindër, shkollë, DKA dhe komunitetin e gjerë. Vetëm përmes një angazhimi të koordinuar dhe planifikimi të qëndrueshëm mund të sigurojmë qasje të barabartë dhe cilësi në arsim për të gjithë nxënësit, duke u dhënë mundësinë që të arrijnë potencialin e tyre të plotë.

Fusha 3: Edukimi emocional dhe social

Në kontekstin e zhvillimeve të reja arsimore dhe transformimit të sistemit të edukimit drejt një mësimi gjithëpërfshirës dhe tërëditor, edukimi emocional dhe social luan një rol shumë të rëndësishëm. Nga arsimi parafillor e deri në fund të arsimit të mesëm të ulët (klasa e 9-të), formësimi i kompetencave emocionale dhe sociale të nxënësve janë thelbësore për ndërtimin e një shoqërie të shëndetshme, të barabartë dhe të ndërgjegjshme.

Edukimi emocional dhe social përfshin:

- **Vetëdijesim emocional** (njohja e emocioneve),
- **Menaxhimin e emocioneve dhe vetëkontrollin,**
- **Kuptimi i ndjenjave të tjerët** (empati)
- **Aftësi sociale** (komunikimi dhe bashkëpunimi)
- **Ndërtimin e marrëdhënieve të shëndetshme** dhe
- **Marrjen e vendimeve të përgjegjshme.**

Këto aftësi janë të domosdoshme për zhvillimin e personalitetit të fëmijëve, mirëqenien e tyre psikologjike dhe përfshirjen aktive në jetën sociale dhe shkollore.

Mësimi tërëditor dhe roli i institucioneve

Kalimi drejt një modeli të mësimit tërëditor kërkon jo vetëm shtim të orëve mësimore, por edhe një ristrukturim të përmbajtjes, metodologjisë dhe organizimit institucional. Në këtë kontekst, edukimi emocional dhe social duhet të përfshihet në mënyrë sistematike si pjesë e pandashme e kurrikulës.

Integrimi i edukimit emocional dhe social në kurrikulë

- Në arsimin **parashkollor**, përmes lojës, këngëve dhe bashkëpunimit, fëmijët mësojnë të njohin emocionet e tyre dhe të tjerëve.
- Në **ciklin fillor** (klasa 1–5), fokusi është në ndërgjegjësimin për ndjenjat, krijimin e lidhjeve sociale dhe rregullimin emocional.
- Në **ciklin e mesëm të ulët** (klasa 6–9), përfshihen temat si zgjidhja e konflikteve, vendimmarrja, ndërtimi i identitetit.

Për realizimin efektiv të kësaj fushe, kërkohet:

- Trajnim i vazhdueshëm i mësimeve për edukimin emocional dhe social;
- Angazhim i psikologëve në çdo shkollë;
- Bashkëpunim i ngushtë me prindërit për të ndërtuar një qasje të unifikuar midis shtëpisë dhe shkollës;
- Krijimi i klubeve, aktiviteteve jashtëshkollore dhe hapësirave të sigurta për shprehje emocionale.

Praktikat më të mira në organizimin e mësimit tërëditor

- **Krijimi i rutinave ditore që përfshijnë reflektim emocional**
- **Integrimi i temave sociale në lëndë të tjera**
- **Zhvillimi i projekteve me bazë komunitare**
- **Përdorimi i metodave bashkëkohore**

Edukimi emocional dhe social sipas grupmoshave

Cikli Parashkollor

Qëllimi: Zhvillimi i ndërgjegjësimit për emocionet bazë dhe sjelljen me të tjerët.
Kompetencat kryesore që synohen:

- Të identifikojë emocionet themelore (gëzim, trishtim, frikë, zemërim);

- Të ndërveproj në mënyrë pozitive me bashkëmoshatarët;
- Të mësojë të presë radhën dhe të ndajë lodrat.

Aktivitete të Sugjeruara:

1. Këndet e emocioneve
2. Pasqyrimi emocional
3. Teatri me kukulla
4. Pikturimi i ndjenjave
5. Rrethi i miqësisë

Cikli Fillor (Klasa 1–5)

Qëllimi: Ndërtimi i aftësive për vetëkontroll, empati, bashkëpunim dhe zgjidhje konflikti.

Kompetencat Kryesore që Synohen:

- Të emërtojë dhe shprehë emocionet në mënyrë të përshtatshme;
- Të kuptojë perspektivat e të tjerëve;
- Të zgjidhë konflikte me fjalë dhe jo me agresivitet;
- Të ndërtojë miqësi të shëndetshme dhe të qëndrueshme.

Aktivitete të Sugjeruara:

1. Ditari emocional
2. Kutia e përshëndetjeve dhe falënderimeve
3. Lojëra role
4. Rregullat e klasës të vendosura së bashku

Cikli i mesëm i ulët (Klasa 6–9)

Qëllimi: Forcimi i vetëdijes, ndërtimi i identitetit personal dhe social, menaxhimi i stresit dhe vendimmarrja etike.

Kompetencat kryesore që synohen:

- Të kuptojë marrëdhënien midis ndjenjave, mendimeve dhe sjelljes;
- Të zhvillojë qëndrueshmëri emocionale në përballje me sfida;
- Të marrë vendime të arsyetuara dhe të përgjegjshme;
- Të menaxhojë konfliktet ndërpersonale në mënyrë konstruktive.

Aktivitete të sugjeruara:

1. Diskutime të drejtuara mbi emocionet dhe sjelljet sociale
2. Lojëra në role
3. Reflektim dhe shkrim në ditar emocional
4. Ushtrime të bashkëpunimit në grup
5. Ushtrime për menaxhimin e stresit dhe relaksimit
6. Biseda mbi ndikimin e teknologjisë dhe rrjeteve sociale

Fusha 4: Aktivitetet fizike dhe rekreative

Aktiviteti fizik dhe rekreativ është një komponent shumë i rëndësishëm në strukturën e mësimin tërëditor. Ai kontribuon jo vetëm në zhvillimin fizik të nxënësve, por edhe në mirëqenien e tyre emocionale, sociale dhe mendore. Më poshtë janë të paraqitura disa elemente kyçe dhe shembuj konkretë brenda kësaj fushe:

Qëllimi i fushës:

Të promovojë një stil jete të shëndetshëm dhe aktiv.

Të rrisë energjinë dhe përqendrimin e nxënësve gjatë procesit mësimor.

Të forcojë ndjenjën e bashkëpunimit, shoqërimit dhe disiplinës përmes lojërave dhe aktiviteteve të përbashkëta.

Llojet e aktiviteteve fizike dhe rekreative:

1. Aktivitete sportive të organizuara: Futboll, volejboll, basketboll, hendboll, gara të vrapimit, kërcime së gjati ose së larti
2. Lojëra tradicionale
3. Ecje dhe ekskursionë rekreative
4. Aktivitete relaksuese
5. Koha e lirë aktive (gjatë pushimeve)
6. Puna në grupe rekreative

Përfitimet për nxënësit:

- Përmirësim i shëndetit fizik dhe qarkullimit të gjakut.
- Rritje e vetëbesimit dhe zvogëlim i stresit.

- Nxitje e ndërveprimit social dhe bashkëpunimit ndërmjet bashkëmoshatarëve.
- Rritje e motivimit dhe përqendrimit në procesin mësimor.

Fusha 5: Krijimtaria dhe arti

Në shkollat ku ofrohet qëndrim ditor, programet pas mësimit formal nuk janë thjesht përkujdesje, por një mundësi për zhvillim të gjithanshëm të fëmijës. Një ndër aspektet më të rëndësishme të këtij qëndrimi është përfshirja aktive e fëmijëve në aktivitetet krijuese dhe artistike, të cilat ndihmojnë në formimin e personalitetit, në zhvillimin emocional dhe intelektual, si dhe në rritjen e vetëvlerësimit të tyre.

Rëndësia e artit dhe krijimtarisë në zhvillimin e fëmijëve

1. Zhvillimi personal dhe emocional

Artet i ndihmojnë fëmijët të shprehin ndjenjat, shqetësimet apo gëzimet e tyre në mënyra simbolike dhe të sigurta. Vizatimi, piktura, drama apo muzika krijojnë një hapësirë ku fëmijët ndihen të lirë për të treguar atë që nuk mund ta shprehin me fjalë.

2. Nxitja e mendimit kritik dhe zgjidhjes kreative të problemeve

Procesi krijues i nxit fëmijët të mendojnë ndryshe, të eksplorojnë mënyra të reja të zgjidhjes së problemeve dhe të eksperimentojnë me ide.

3. Zhvillimi i aftësive motorike dhe koordinimit

Veprimtaritë që përfshijnë prerjen, ngjyrosjen, vizatimin apo formësimin me duar ndihmojnë në zhvillimin e motorikës së imët dhe koordinimit mes syrit dhe dorës.

4. Forcimi i aftësive sociale

Shumë prej aktiviteteve krijuese zhvillohen në grupe ose në bashkëpunim me fëmijë të tjerë, duke ndihmuar në ndërtimin e aftësive për bashkëpunim dhe respektimin e ideve të ndryshme.

Shembuj të veprimtarive krijuese dhe artistike në qëndrimin ditor

- Orë të artit pamor – me vizatime, piktura, kolazhe, punime me plastelinë, letër, tekstile dhe materiale të riciklueshme.
- Punime për festat dhe sezonet – krijime që lidhen me Ditën e Mësuesit, Stinët e vitit etj.
- Dramë dhe teatër – ku fëmijët marrin role, shkruajnë skena të shkurtra apo improvizojnë shfaqje.
- Muzikë dhe këndim – përfshirje në këngë popullore, këngë për fëmijë, njohje me ritmin dhe instrumente të thjeshta.
- Tregime dhe krijimtari letrare – fëmijët shkruajnë tregime të shkurtra, poezi, apo përralla.
- Ekspozita dhe prezantime – organizimi i aktiviteteve ku punët e fëmijëve ekspozohen ose prezantohen.

Roli i mësuesve dhe edukatorëve

Edukatorët në qëndrimin ditor luajnë një rol të rëndësishëm në nxitjen e krijimtarisë. Ata duhet të:

- krijojnë një ambient të sigurt dhe të ngrohtë ku fëmijët ndihen të lirë për të krijuar;
- ofrojnë mjete dhe materiale të ndryshme për punë krijuese;
- motivojnë dhe inkurajojnë fëmijët pa i gjykuar për rezultatet;
- ndihmojnë fëmijët të shprehin emocionet dhe mendimet e tyre në mënyrë të shëndetshme.

Përfundime

Përfshirja e aktiviteteve krijuese dhe artistike në programet e qëndrimit ditor e pasuron përvojën e fëmijës në shkollë dhe ndihmon në ndërtimin e një personaliteti të balancuar, të sigurt dhe të ndjeshëm ndaj bukurisë, kulturës dhe shprehjes vetjake. Arti nuk është vetëm një formë argëtimi për fëmijët – është një mjet i fuqishëm për të mësuar, për të komunikuar dhe për të ndërtuar botën e tyre të brendshme.

Fusha 6: Kujdesi dhe mirëqenia

1. Qëllimi i fushës

Fusha “Kujdesi dhe mirëqenia” ka për qëllim të sigurojë një mjedis të shëndetshëm, të sigurt dhe mbështetës për të gjithë nxënësit që do të përfshihen në mësim tërëditor. Synohet që çdo fëmijë të ndihet i respektuar, i mbrojtur dhe i mbështetur në aspektin fizik, emocional dhe social gjatë gjithë kohës së qëndrimit në shkollë.

2. Objektivat kryesore

- Të garantohet mirëqenia fizike dhe psikologjike e nxënësve gjatë gjithë ditës.
- Të ofrohet mbështetje për zhvillimin e shëndetshëm social dhe emocional.
- Të sigurohet kujdes personal i përshtatur për moshën dhe nevojat e nxënësve.
- Të përfshihen prindërit dhe komuniteti shkollor në procesin e kujdesit gjithëditor.

3. Aktivitetet dhe masat konkrete

a) Ushqyerja dhe higjiena

- Ofrimi i një vakti të ngrohtë dhe dy ushqimeve të lehta gjatë ditës.
- Respektimi i dietave të personalizuar (alergji, intoleranca etj.).
- Edukimi i nxënësve mbi higjienën personale dhe shëndetin.
- Mbikëqyrje gjatë vakteve për të siguruar konsumimin e duhur të ushqimit

b) Kujdesi psikologjik dhe social

- Mbështetje nga psikologu i shkollës për menaxhimin e emocioneve dhe ndërtimin e marrëdhënieve sociale.
- Organizimi i aktiviteteve grupore që nxisin bashkëpunimin dhe vetëbesimin.

c) Pushimi dhe relaksimi

- Sigurimi i një kohe të strukturuar për pushim, me mundësi për relaksim të mbikëqyrur.
- Ambient i qetë për lexim të lirë ose aktivitete të qeta pas drekës.

d) Siguria dhe ndihma e parë

- Zbatimi i rregulloreve të brendshme për parandalimin e bullizmit dhe dhunës
- Monitorimi periodik i gjendjes shëndetësore të nxënësve
- Bashkëpunim me personel mjekësor për kontrollin e shëndetit
- Prania e një plani të emergjencave dhe një personi të trajnuar në ndihmën e parë
- Rishikim dhe kontroll periodik i kushteve fizike të shkollës (ndriçim, ngrohje, ajrim, pastërti).

4. Burimet njerëzore të angazhuara

- Staf mbështetës për ushqyerjen dhe mirëmbajtjen e ambienteve.
- Psikolog dhe punonjës social për mbështetjen emocionale.
- Përkrahje e nxënësve me nevoja të veçanta përmes stafit të trajnuar
- Koordinator i programit tërëditor për menaxhimin e përditshëm.

5. Bashkëpunimi me prindërit

- Informim i rregullt i prindërve për ecurinë dhe mirëqenien e fëmijëve.
- Përfshirje e prindërve në aktivitete të caktuara ditore ose mujore.
- Krijimi i një platforme digjitale ose ditari komunikimi për çdo nxënës.

6. Mekanizmat e monitorimit dhe vlerësimit

- Hartimi i formularëve të vlerësimit periodik për mirëqenien e nxënësve.
- Mbledhje mujore me stafin për të analizuar progresin dhe nevojat.
- Anketim i prindërve dhe nxënësve për përmirësim të vazhdueshëm.

Përkufizimi i problemit

Strategjia e mësimi tërëditor është një ndër qasjet bashkëkohore më efikase në procesin mësimor, e cila synon zhvillimin e të menduarit kritik, aftësive hulumtuese dhe zgjidhjes së problemeve nga ana e nxënësve, lehtëson detyrimet e prindërve në raport me fëmijët e tyre gjatë orarit mësimor, po ashtu ndihmon të nxënit tek fëmijët.

Mësimi tërëditor në shkollë, përveç edukimit të vazhdueshëm, trajtimit të rregullt dhe të vazhdueshëm arsimor, plotëson edhe aspektet ekzistenciale dhe nevojat e nxënësve në kuptim të rregullit, ushqimit të organizuar, mirëmbajtjes së rregullt të higjienës personale dhe një shoqërizim të përgjithshëm, nëpërmjet formave të ndryshme të përfshirjes së drejtpërdrejtë në mjedisin shoqëror.

Roli i mësimdhënësit në këtë fazë është vendimtar, Drejtoria Komunale e Arsimit duhet të veprojë ngushtë me të gjithë mësimdhënësit në nivel të komunës po ekskluzivisht me mësimdhënësit në shkollat të cilat janë të përfshira në mësimin tërëditor. Secili nga mësimdhënësit sidomos në këto tri shkolla ShFMU “Abdullah Krashnica”, ShFMU “Metush Krasniqi” dhe ShFMU “Skënderbeu” duhet të kenë një përkushtim të shtuar që me aktivitetet e tyre duhet të formulojnë problemin në mënyrë të tillë që të ngjallë kureshtje, të nxisë pyetje dhe të hapë rrugën për eksplorim dhe zgjidhje nga ana e vet nxënësve, në vend që të ofrojë informacione të gatshme, mësimdhënësi duhet të udhëheq procesin duke u bërë lehtësues i të nxënit.

Menagjmenti i shkollës, stafi mbështetës, mësimdhënësit dhe i gjithë stafi i shkollave përkatëse me përkushtimin e tyre maksimal për një ambient ku nxënësit mund të mësojnë të analizojnë, të bëjnë pyetje, të provojnë zgjidhje të ndryshme dhe të mësojnë nga gabimet e tyre, ky proces e bën mësimin më domethënës, më të qëndrueshëm dhe më të afërt me jetën reale.

Drejtoria e Arsimit ka një rol udhëheqës dhe mbikëqyrës në zbatimin e politikave arsimore, përfshirë edhe strategjinë e mësimi tërëditor. Ajo është përgjegjëse për krijimin e kushteve të nevojshme infrastrukturore, pedagogjike dhe sociale për realizimin cilësor të këtij strategjie. Një komponent themelor në këtë proces është ndërtimi i urave të komunikimit të qëndrueshëm me prindërit.

Nga hulumtimet që janë bërë mbi nevojën e implementimit të mësimi tërëditor shohim se mësimi tërëditor është i rëndësishë së veçantë, ngase qëndron në relacion me projektet prioritare të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Drejtorisë Komunale të Arsimit, për faktin se implementimi i Kornizës së Re Kurrikulare kërkon qasje integruese për planifikimin dhe zbatimin e metodave kreative të shfrytëzimit e të hapësirave shkollore, me qëllim përkrahjen e të gjithë nxënësve në zotërimin e kompetencave kryesore të përcaktuara me dokumentet kurrikulare.

6. PËRFSHIRJA E PRINDËRVE DHE KOMUNITETIT

Përfshirja aktive e prindërve dhe komunitetit është një komponent thelbësor për suksesin e mësimit tërëditor. Ky model kërkon bashkëpunim të ngushtë ndërmjet shkollës, familjes dhe faktorëve komunitarë për të krijuar një mjedis mbështetës dhe të gjithanshëm për nxënësit.

Roli i prindërve përfshin:

- Mbështetjen e fëmijëve në përmbushjen e detyrave jashtë orarit tradicional.
- Pjesëmarrjen në takime dhe aktivitete shkollore.
- Bashkëpunimin me mësimitdhënësit për të përcjellë përparimin dhe nevojat e fëmijës.

Roli i komunitetit përfshin:

- Ofrojnë burime dhe hapësira për aktivitete jashtëklasore.
- Angazhojnë profesionistë lokalë për ligjërata, punëtori apo mentorim.
- Mbështesin me logjistikë, ushqim apo siguri, sidomos në shkolla ku nxënësit qëndrojnë gjatë gjithë ditës.

Përmes një bashkëpunimi të strukturuar dhe të qëndrueshëm, shkolla mund të ndërtojë ura besimi dhe partneriteti me prindërit dhe komunitetin, duke rritur ndjeshëm cilësinë dhe efektivitetin e mësimit tërëditor.

Komunikimi i prindërve me mësimitdhënësin është çelësi i suksesit të nxënës të fëmijës. Prania, komunikimi në shkollë e motivon fëmijën të japë më të mirën e tij/saj dhe i ndihmon prindërve të punojnë së bashku me mësimitdhënësit për të përmirësuar procesin e mësimit të fëmijës. Thjesht duke u paraqitur në shkollë prindërit mund ta rrisin motivimin dhe performancën e fëmijës.

Drejtoria e Arsimit në bashkëpunim me shkollat përkatëse do të inkurajoj dhe mbështes gjithnjë mundësitë për të komunikuar me mësimitdhënësin rreth përparimit të fëmijës tuaj, në mbledhje të përgjithshme me gjithë klasën si dhe në orë individuale konsultimi prindër-mësimitdhënësi. Në këtë mënyrë do të mund të punojmë së bashku për të zhvilluar këtë strategji për të mbështetur tutje talentet e së ardhmes.

7. SWOT analiza

Teknika hulumtuese SWOT shërben si një mjet strategjik për të analizuar një situatë, për të kuptuar pozicionin aktual dhe për të planifikuar veprimet e ardhshme në mënyrë më efektive.

Tabela 2. SWOT analiza

Pikat e forta/Përparësitë	Pikat e dobëta/Dobësitë
Infrastruktura shkollore Stafi i kualifikuar dhe profesional Mbështetje e plotë institucionale Reduktimi i kohës së lirë të pa kontrolluar Jetë të begatë shkollore Mjete dhe rekuizita sportive të mjaftueshme Ofrim i ushqimit të shëndetshëm	Mungesa e kuzhinës në shkollë Plotësim me shërbim profesional në shkollë Mungesa e ujit të pijshëm në ShFMU “Skenderbeu” dhe “Metush Krasniqi” Mungesa e klimatizimit në shkollë Mungesa e pajisjeve për printim Bashkëpunimi i shkollës me komunitetin Furnizim jo i qëndrueshëm i internetit
Kërcënimet/Rreziqet	Mundësitë
Mungesë motivimi për nxënës në orarin e pas ditës Lodhja e nxënësve nga zgjatja e orarit Vullneti tek mësimdhënësit Raportet kolegiale në mes stafit në shkollë Trajnimi i duhur për mësimdhënësit Implementimi i strategjisë në shkollë	Zhvillimi i shkathtësive tek nxënësit Nxitja e nivelit të menduarit kritik Zbatimi i teknologjisë në proces Mundësi përdorimit të laboratorëve virtual në mësimdhënie Bashkëpunimi me komunitetin dhe prindërit Zhvillimi profesional i mësimdhënësve Avancimi i besimit tek komuniteti Hapësirë e madhe e zhvillimit emocional dhe social Mundësi për prindërit për zhvillim profesional Avancimi i rezultateve shkollore Identifikimi nxënësve të talentuar Mundësi për orientim profesional

8. ANALIZA E GJENDJES NË SHKOLLA

Analiza e gjendjes aktuale në ShFMU "Abdullah Krashnica"

1. Të dhëna të përgjithshme

Shkolla ndodhet në një zonë rurale dhe ofron mësim për ciklin fillor 0-9. Mësimi zhvillohet në një ndërrim të vetëm, ora mësimore zgjate 45 minuta.

Numri i nxënësve: 214 nxënës, të ndarë në ciklin parashkollor, fillor dhe të mesëm te ulët.

2. Infrastruktura dhe ambientet shkollore

- Numri i klasave mësimore: 16 – Mjaftueshëm për të akomoduar të gjithë nxënësit.
- Kabinete mësimore: 3 (Kimi-Fizike-Biologji, Teknologji Informative, Art-Muzikë)
- Salla e edukatës fizike: 1(e kompletuar me dhoma te zhveshjes dhe tualete)
- Klasa për parashkollor: 1 – Integron përgatitjen e hershme edukative
- Bibliotekë: 1 – E domosdoshme për zhvillimin e leximit dhe studimit të pavarur
- Hapësira të brendshme: Të pastra dhe me ndriçim adekuat
- Hapësira të jashtme: Dekoruar me drunj dhe hapësira të gjelbëruara

3. Pajisjet dhe teknologjia didaktike

- Pajisje funksionale: Laptopë, Smart TV, Projektorë
- Tabela të bardha: Me markera
- Inventari i klasave: I mjaftueshëm
- Mungon klimatizimi në klasat mësimore

4. Higjiena dhe sanitarja

- Tualete për nxënës:
- Femra: 4
- Meshkuj: 3 + 1
- Tualete për staf: 1

5. Staf dhe burimet njerëzore

Tabela 3. Staf dhe burimet njerëzore

Pozita	Numri	Sqarim
Staf i mësimdhënësve	27	1 mësues mbështetës
Staf teknik	5	3 punëtor teknik
Shërbim profesional	2	Psikolog, 2 asistent për FNV
Personeli udhëheqës	1	Zyrtari administrativ

6. Vlerësime të përgjithshme

Tabela 4. Vlerësimet e përgjithshme

	Vlerësimet	Rekomandimet
Infrastrukturë shkollore e qëndrueshme	E përmbushur	Hapësira e kuzhinës për nxënës
Nyjet sanitare	Funksionale	Të rregullohet një wc për persona me NV
Furnizim me ujë	Furnizim nga shpime nëntokësore Ka lidhje në ujësjellësin e fshatit	
Inventari	I mjaftueshëm	
Stafi i mësimdhënësve	I kualifikuar	DKA të siguroj stafin shtesë sipas fondit të orëve
Shërbimi profesional	I kënaqshëm	Të ofrohen shërbime psikologjike dhe mbështetje për FNV
Staf teknik	Jo i mjaftueshëm	Të shtohet numri i ST

Analiza e gjendjes aktuale në ShFMU "Metush Krasniqi"

Të dhëna të përgjithshme

Në shkollën “Metush Krasniqi” aktualisht ndjekin mësimin 180 nxënës të ndarë në ciklin parashkollor, fillor dhe të mesëm te ulët.

Procesi mësimor zhvillohet në një ndërrim, duke respektuar orarin standard shkollor 45 minuta.

2. Infrastruktura dhe ambientet shkollore

Infrastruktura fizike e shkollës është funksionale, me disa kufizime që lidhen me mungesën e disa ambienteve mbështetëse të nevojshme për modelin e mësimi tërëditor.

Bazuar në të dhënat e paraqitura nga shkolla fillore “Metush Krasniqi” në Rogaçicë, për vitin shkollor 2024/25, vijon analiza e detajuar e gjendjes aktuale:

-Numri i klasave mësimore: 15

-Kabinete mësimore: 5 (Muzikë, Kimi-Biologji, TIK, Kabineti i artit, Kabineti Matematikë-Fizikë, vetëm hapësira, pa furnizime)

- Salla e edukatës fizike pa rekuizita (me 2 dhoma të zhveshjes)

- Klasa për parashkollor: 1

-Bibliotekë-hapësira për marrjen e liktyrave, zhvillimin e leximit dhe studimit të pavarur.

Hapësirat e brendshme janë të pastra dhe me ndriçim të mirë

3. Inventari, pajisjet teknologjike dhe didaktike

- Inventari i klasave: I mjaftueshëm

- Mungon klimatizimi në klasat mësimore

- Pajisje funksionale: Laptopë, Smart TV, Projektore

4. Higjiena dhe sanitaria

Tualet për nxënës:

- Femra: 8

- Meshkuj: 8

- Tualet për staf: 2

- Tualet për fëmijë me nevoja të veçanta: 1

5. Staf dhe burimet njerëzore

Tabela 5. Staf dhe burimet njerëzore

Pozita	Numri	Sqarim
Staf i mësimdhënësve	27	
Staf teknik	7	
Shërbim profesional	3	Pedagog, 2 asistent për FNV
Personeli udhëheqës	1	Zyrtari administrativ

6. Vlerësime të përgjithshme

Tabela 6. Vlerësimet e përgjithshme

	Vlerësimet	Rekomandimet
Infrastrukturë shkollore e qëndrueshme	E përmbushur	Hapësira e kuzhinës për nxënës
Nyjet sanitare	Funksionale	
Furnizim me ujë	Ka burim nga rënja e lirë	Të mundësohet lidhja në ujësjellësin
Inventari	I mjaftueshëm	
Stafi i mësimdhënësve	I kualifikuar	DKA të siguroj stafin shtesë sipas fondit të orëve
Shërbimi profesional	I kënaqshëm	Të ofrohen shërbime pedagogjike dhe mbështetje për FNV
Staf teknik	I mjaftueshëm	

Analiza e gjendjes aktuale në ShFMU "Skenderbu"

1. Burimet njerëzore

Numri i përgjithshëm i punëtorëve: 43 Ky numër sugjeron një trupë të qëndrueshme për një shkollë me 18 klasë. Ndarja përfshin mësimdhënës, staf ndihmës, teknik dhe administratë, struktura organizative pedagogjike duket e kompletuar.

2. Infrastrukturë dhe ambiente mësimore

Klasat mësimore: 18 – Numër i mjaftueshëm për të akomoduar nxënësit në ciklet e ulëta dhe të larta.

Kabinete: 4 – Kabinetet janë për lëndët (Kimi,Tik,Art,dhe muzikë).

Salla e edukatës fizike: 1 – Ofron hapësirë për zhvillimin e aktiviteteve fizike të rregullta.

Amfiteatri: 1 – Ofron mundësi për zhvillim të aktiviteteve kulturore dhe prezantime.

Klasa për pingpong: 1 – Aktivitet shtesë që kontribuon në zhvillimin fizik.

Biblioteka: 1 – Element thelbësor për zhvillimin e leximit .

Klasa për parashkollor: 1 – Tregon përfshirje në përgatitjen parashkollore.

Klasa për ndërmjetësim: 1 – Reflekton qasje bashkëkohore për menaxhimin e konflikteve dhe zhvillimin emocional-social.

3. Higjiena dhe mirëqenia

Tualetet:

Për gjininë femërore: 3

Për meshkuj: 3 të jashtme dhe 3 të brendshme

Për staf: 1

Për fëmijë me nevoja të veçanta: 1

Kjo strukturë e tualeteve është relativisht e mirë, por edhe përmbush standardet për numrin total të nxënësve dhe stafin.

4. Mjedisi shkollor

Ambient i jashtëm: Dekoruar me drunj dekorativë dhe hapësira gjelbëruese.

Ambient i brendshëm: I pastër, me ndriçim të mjaftueshëm.

